



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 80, DATË 03.09.2020

PËR
ZGJERIMIN E ZONËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË SHOQËRISË “MRM”
SH.P.K., AUTORIZUAR PËR PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT
AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE MBËSHTETUR NË RRJET KABLLOR “TV
KABLLOR KORÇA”

Në mbështetje të nenit 19, pika 1/b, nenit 55, pika 4/b të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin nr. 99, datë 07.06.2017 të AMA-s, si dhe pas shqyrtimit të aplikimit nr. 1998 prot., datë 20.07.2020, të shoqërisë “MRM” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Korça”, për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “MRM” sh.p.k., me administrator z. Aurel Koçibelli dhe NIPT: K33927043D, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Korça”, në njësitë administrative Voskop dhe Mollaj.
2. Zona e ofrimit të shërbimit të shoqërisë “MRM” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Korça”, ndryshon në njësitë administrative Korçë, Maliq, Drenovë, Libonik, Bulgarec, Voskop dhe Mollaj.
3. Kushtet e autorizimit të shoqërisë “MRM” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Korça”, përveç zonës së ofrimit të shërbimit, mbeten të pandryshuara.
4. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA